

VENDIM
Nr. 955, datë 29.12.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE TË SIGURUAR QË
PËRJASHTOHEN NGA PAGESAT E DREJTPËRDREJTA TË SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE¹**

(Ndryshuar me VKM nr.946, datë 28.12.2016)

(I perditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 2, dhe 41, të ligjit nr. 10 383, datë 24.11.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshirjen nga pagesat e drejtpërdrejta për shërbimet shëndetësore, që janë pjesë e listës së barnave të rimbursueshme, të paketave të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor dhe të kujdesit spitalor që mbulohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, në masën e përcaktuar, për kategoritë e mëposhtme:

- a) Fëmijët 0 - 18 vjeç;
- b) Invalidët e plotë, përfshirë edhe invalidët paraplegjikë, tetraplegjikë dhe të verbrit e plotë;
- c) Invalidët e luftës;
- ç) Veteranët;
- d) Personat që gëzojnë statusin e ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politikë;
- dh) Jetimët.
- e) *Personat që përfitojnë pagesën për aftësinë e kufizuar.*

2. Përfshirjen nga pagesat e drejtpërdrejta, për alternativat e para të barnave të listës së barnave të rimbursueshme, për kategoritë e mëposhtme:

- a) Pensionistët;
- b) Personat e paraburgosur dhe të dënuarit me burgim;
- c) Azilkërkuessit;
- ç) Viktimat e trafikimit.

3. *Përfshirjen nga pagesat e drejtpërdrejta për alternativat e para të barnave të listës së barnave të rimbursueshme për personat që nuk bëjnë pjesë në kategoritë e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, për trajtimin e sëmundjeve kronike, sipas listës së miratuar me urdhër të ministrit të Shëndetësisë.*

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ VKM nr.955, datë 29.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.214/2014
VKM nr.946, datë 28.12.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.264/2016.